



**PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
KRYETARI**

URDHËR

Nr. 25, datë 11/05/2018

**PËR NISJEN E PROCESIT ZGJEDHOR NË TË GJITHA NIVELET E
STRUKTURËS VENDORE ORGANIZATIVE TË PARTISË DEMOKRATIKE**

Në mbështetje të nenit 51/4 të Statutit të Partisë Demokratike, të nenit 10, 29, 30, 31, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, me qëllim organizimin e procesit zgjedhor në çdo nivel të strukturës organizative vendore të Partisë Demokratike;

Me synim:

- Rifreskimin statutor të strukturave drejtuese vendore, nëpërmjet zgjedhjes dhe promovimit të anëtarëve më të aftë dhe të sprovuar, të gatshëm të marrin përsipër sfidën elektorale dhe ta drejtojnë Partinë Demokratike drejt suksesit;
- Riorganizimin e Partisë Demokratike në të gjitha nivelet e strukturës vendore të saj për të rritur kontaktin me votuesin, identifikimin e tij si dhe për të kontrolluar me efikasitet territorin elektorale;
- Aplikimin e parimit “një anëtar-një votë” tashmë edhe në nivelin e Grupseksionit, si shprehje e qartë e përfshirjes së anëtarësisë në vendimarrje dhe demokratizimit të mëtejshëm të jetës politike në Partinë Demokratike,

Në kushtet kur Zgjedhjet Vendore po afrojnë, dhe kur:

- Shqiptarët presin zgjidhje të menjëhershme për problemet e thella sociale dhe ekonomike që ka vendi;
- Përballë Partisë Demokratike qëndron një mazhorancë e kriminalizuar, e korruptuar, një qeverisje fasadë dhe shumë larg interesave të shqiptarëve;
- Kuvendi i Partisë Demokratike ka miratur Statutin e ri të Partisë Demokratike, statut i cili hedh hapa shumë të rëndësishëm për zbatimin e një

koncepti të ri organizativ në territor, ku përgjegjësitë janë individuale dhe rezultatet të matshme:

URDHËROJ:

1- Nisjen e procesit zgjedhor të strukturave drejtuese të Degës, në nivel Grupseksioni dhe Seksioni, në bazë të parimeve të reja të sanksionuara në Statutin e Partisë Demokratike si dhe nevojës për rritjen e efikasitetit elektorale të Partisë Demokratike;

2- Afati për mbylljen e këtij procesi zgjedhor është 45 ditë.

Për këtë:

3- Ngrihet Grupi i Punës për çdo Qark, përgjegjës për ndjekjen e këtij procesi, sipas përbërjes së mëposhtme:

- a. Kryetari i Grupit të Punës dhe të Deleguar të tjerë, të caktuar nga Kryetari i PDSH-së;
- b. Deputetët, anëtarët e Këshillit Kombëtar dhe Koordinatorët që mbulojnë territorin e Degës;
- c. Kryetari i Degës si dhe Anëtarë të Kryesisë së degës;

4- Grupi i Punës merr masa organizative dhe fton të bëhen pjesë e procesit zgjedhor e të marrin përsipër përgjegjësi, potencialet më të mira dhe më të afta njerëzore të PDSH-së në territorin përkatës. Këtu përfshihen drejtuesit aktualë të PDSH-së, anëtarë dhe ish-anëtarë të Këshillit Kombëtar, funksionarë dhe ish-funksionarë të lartë vendorë dhe qendrorë, ish-deputetë, njerëz me reputacion të lartë dhe figura të njohura të zonës, të cilët duan të kontribuojnë në PDSH.

5- Grupi i Punës mblidhet brenda datës 14 maj 2018 dhe merr këto masa për organizimin e procesit për çdo Degë të PDSH-së:

- a. Ngre Nëngrupet e Punës për çdo Grupseksion të çdo Dege. Në përbërje të Nëngrupeve të Punës hyjnë kategoritë 3/a/b/c. Këto Nëngrupe janë përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve në çdo Grupseksion dhe Seksionet përbërëse të tij, sipas afateve, procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë Urdhër;

- b. Merr vendim për ndarjen e Grupseksioneve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Urdhër, duke respektuar përfshirjen sa më të madhe të burimeve njerëzore në procesin zgjedhor si dhe shmangien e konfliktit të interesit;
- c. Përcakton kalendarin e procesit zgjedhor në nivel Grupseksioni dhe Seksioni të Degës, si më poshtë:
 - i. Proçesi zgjedhor hapet me zgjedhjet në nivel Grupseksioni.
 - ii. Vetëm pasi mbyllet kjo fazë (pika i), mbahen zgjedhjet në nivel Seksioni për çdo Grupseksion të Degës;
 - iii. Zgjedhjet në Grupseksione mbahen jo më vonë se data 7 qershor 2018;
 - iv. Zgjedhjet në Seksione mbahen jo më vonë se data 30 qershor 2018.

Parimet kryesore të zgjedhjeve në nivel Grupseksioni dhe Seksioni

Për Grupseksionin:

6- Proçesi i zgjedhjeve në Grupseksion zhvillohet i pari, sipas parimit “Një anëtar-një votë”. Ky proces zhvillohet pas riorganizimit territorial të Grupseksionit, nëse Grupi i Punës ka marrë paraprakisht një vendim të tillë, sipas pikës 5/b të këtij Urdhëri.

- a. Një Grupseksion ngrihet mbi një territor i cili në zonat urbane nuk përmban më shumë se 5 mijë zgjedhës;
- b. Në zonat rurale ky numër mund të jetë më i ulët. Në këtë rast respektohet ndarja sipas ish-komunave, tradita, kultura, homogjeniteti i zonës, si dhe shtrirja gjeografike e saj;
- c. Mbështetur në pikën 6/a, ndarja e territorit në Grupseksione në zonat urbane, duhet të përkohet, aty ku është e mundur, me konceptin e ish-“lagjeve” të mëparshme;
- d. Në vijim të pikës 6/a, në rast se numri i zgjedhësve në një Grupseksion është më i lartë se 5 mijë, Grupi i Punës mund të marrë vendimin e ngritjes së një Grupseksioni të dytë. Në çdo rast, vendimi për ndarjen e grupseksionit bazohet tek principi i kontrollit sa më efikas të territorit, të efikasitetit të punës dhe burimeve njerëzore në dispozicion;
- e. Kryetari i Grupseksionit, si rregull, duhet të jetë banor i territorit përkatës.

Për Seksionin:

7- Proçesi i zgjedhjeve në Seksion zhvillohet sipas parimit “një anëtar-një votë”. Ky proces zhvillohet pasi është mbyllur procesi i zgjedhjes së Kryetarit të Grupseksionit dhe paralelisht me procesin e riorganizimit territorial të Seksionit, sipas parimeve të mëposhtëme:

- a. Për çdo Qëndër Votimi (QV) mëmë, duhet të konsolidohet minimalisht një seksion, me numër minimal anëtarësie prej 15 anëtarësh aktivë;
- b. Nëse për momentin, për arsye objektive ky numër (15 anëtarë aktivë) nuk mundësohet, Kryesia e Degës komandon një apo disa persona për ngritjen e këtij seksioni. Më tej, Kryetari i Grupseksionit përkatës sëbashku me Kryesinë e Degës kanë përgjegjësinë për ngritjen e seksionit në këtë territor, sipas parashikimit të pikës 7/a;
- c. Nje QV mëmë (territori përkatës i saj) mund të ketë, sipas rastit, më shumë se një seksion. Si rregull, numri i anëtarëve të Seksionit nuk duhet të jetë më i lartë se 25 anëtarë;
- d. Sidoqoftë, në se ekzistojnë arsye që kanë lidhje me traditën, territorin, burimet njerëzore apo arsye të tjera të vlefshme, Grupi i Punës mund të vendosë shmangien nga rregulli i specifikuar në pikën 7/c;
- e. Anëtarët e Seksionit dhe Kryetari i Seksionit janë detyrimisht banorë të territorit përkatës.

Emërtimi i Unifikuar

8- Grupseksionet dhe Seksionet të emërtohen në mënyrë të unifikuar në të gjithë vendin, sipas shembujve më poshtë:

- a. Seksioni 1/1 do të thotë Seksioni 1 i Grupseksionit 1; Seksioni 2/1 do të thotë Seksioni 2 i Grupseksionit 1, dhe kështu me rradhë.
- b. Çdo seksion paralelisht të ketë edhe numrin e QV-së përkatëse, p.sh “Seksioni 1/1 1170”.
- c. Në Seksionet e zonave rurale paralelisht me numrin vendoset edhe emri i fshatit, p.sh. “Seksioni 1/1 1343-(emri fshatit)”

Proçesi Zgjedhor dhe Kriteret

9- Cdo Nëngrup Pune është përgjegjës dhe procedon fillimisht me zgjedhjet në Grupseksionin përkatës, sipas parimit “një anëtar - një votë”. Afati për këto zgjedhje është data 7 qershor 2018.

- a. Kriteret që duhet të plotësojë Kryetari i Grupseksionit janë:
 - i. Të jetë me arsim të lartë;

- ii. Të jetë me eksperience politike të konsiderueshme, pjesë aktive në aksionin politik të PDSH-së në të paktën tre vitet e fundit;
 - iii. Të njohë mirë territorin ku banon si dhe të ketë reputacion pozitiv në këtë territor dhe më gjerë;
 - iv. Të ketë aftësi në komunikimin me njerëzit;
 - v. Të ofrojë mundësi reale për rritjen e nivelit të rezultateve të Grupseksionit;
 - vi. Si rregull, të jetë banor i territorit që mbulon Grupseksionin;
- b. Kandidatët për pozicionin e Kryetarit të Grupseksionit miratohen nga Grupi i Punës.
 - c. Nëngrupi i Punës dhe Kryetari i Grupit të Punës plotësojnë formularët zgjedhorë (shtojca 2)! Kandidatët për Kryetar Grupseksioni plotësojnë formularin vetëdeklarues të Komisionit të Integritetit dhe Etikës (shtojca 3)!
 - d. Dokumentacioni zgjedhor në Grupseksion mbahet në tre kopje (shtojca 2 dhe 3). Një kopje e dokumentacionit zgjedhor depozitohet pranë degës të PD-së, një kopje të dorëzohet pranë Selisë Qendrore të PD-së, dhe një kopje të qëndrojnë në dosjen e Seksionit përkatës.

10- Çdo Nëngrup Pune, menjëherë pas mbylljes së zgjedhjeve për Kryetar të Grupseksionit, organizon zgjedhjet në të gjitha Seksionet e Grupseksionit të tij brenda datës 30 qershor 2018.

11- Zgjedhjet në Seksione mbahen dhe përfshijnë:

- a. Zgjedhjen e drejtuesve të Seksionit (Kryetar, Sekretar, Kryesi Seksioni). Seksionet me 15 anëtarë të kenë Kryesi me tre persona (Kryetar, Sekretar, Anëtar).
- b. Seksionet me mbi 15 anëtarë të kenë 5 Anëtarë Kryesie. Në Seksionet me mbi 30 anëtarë, kryesia e Seksionit të përbëhet nga 7 anëtarë. Në këtë numër gjithmonë përfshihet edhe Kryetari së bashku me Sekretarin e Seksionit.
- c. Anëtarësia e Seksionit, sipas parimit “një anëtar - një votë”, voton për Kryetarin, Sekretarin dhe Anëtarë të Kryesisë së Seksionit, sipas rastit:
 - i. Në çdo seksion votohet në mënyrë të fshehtë dhe me kandidatura alternative;
 - ii. Arsimi i lartë është prioritet për zgjedhjen e drejtuesve të Seksionit por nuk mund të bëhet pengesë kur rrethanat diktojnë ndryshe;

- iii. Kandidatët për Kryetar Seksioni janë banorë të Qendrës së Votimit që mbulon Seksioni përkatës. Ata duhet të jenë njerëz me eksperiencë politike të konsiderueshme, aktivë në aksionin politik të PDSH-së në të pakten dy vitet e fundit, me njohje shumë të mirë të territorit dhe reputacion të lartë në komunitetin ku banon;
- d. Anëtarësia e Seksionit në këtë proces propozon gjithashtu kandidaturat për Kryetarin e Degës;
- e. Nëngrupi i Punës dhe Kryetari i Grupit të Punës plotësojnë formularët zgjedhorë (shtojca 1)! Kandidatët për pozicione drejtuese në Seksion, plotësojnë formularin vetëdeklarues të Komisionit të Integritetit dhe Etikës (shtojca 3)!
- f. Dokumentacioni zgjedhor në Seksione mbahet në tre kopje (shtojca 1 dhe 3). Një kopje e dokumentacionit zgjedhor depozitohet pranë degës të PD-së, një kopje të dorëzohet pranë Selisë Qendrore të PD-së, dhe një kopje të qëndrojnë në dosjen e Seksionit përkatës.

12- Në rast se Nëngrupi i Punës ka vështirësi apo dështon në marrjen e një vendimi, vendimin përfundimtar e merr Grupi i Punës;

13- Kryetari i Grupit të punës raporton periodikisht për mbylljen e çdo faze zgjedhore sipas afateve të parashikuara në këtë Urdhër. Shtyrja e afateve miratohet vetëm nga Kryetari i Partisë;

14- Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Sekretari Organizativ dhe Degët e PDSH-së, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

SEKRETARI I PËRGJITHSHEM

ARBEN RISTANI

KRYETARI

LULZIM BASHA



SHTOJCA 1

Dega _____
Grupseksioni _____
Seksioni _____
Q.Votimit nr _____

_____, më / /2018

AKTI I ZGJEDHJEVE NË SEKSION

Mbështetur në Nenin 30 të Statutit të PD, në mbledhjen zgjedhore në Seksionin _____ të Grupseksionit _____ Dega _____, u arritën rezultatet e mëposhtme:

Nr. i anëtarëve të seksionit _____ më dt. ___/___/2018 është _____.

Shpërndarja e Votave:

Kandidatë për Kryetar Seksioni:

Emër	Atësi	Mbiemër	Vota	Emër	Atësi	Mbiemër	Vota
1.				4.			
2.				5.			
3.				6.			

Vota te Pavlefshme: _____

Kandidatë për Sekretarë Seksioni:

Emër	Atësi	Mbiemër	Vota	Emër	Atësi	Mbiemër	Vota
1.				4.			
2.				5.			
3.				6.			

Vota te Pavlefshme: _____

Kandidatë për anëtarë Kryesie Seksioni:

Emër	Atësi	Mbiemër	Vota	Emër	Atësi	Mbiemër	Vota	Emër	Atësi	Mbiemër	Vota
1.				4.				7.			
2.				5.				8.			
3.				6.				9.			

Vota te Pavlefshme: _____

Nga votimi u zgjodhën për të drejtuar seksionin:

Emër Atesi Mbiemër

1. _____

*Nr i telefonit _____

2. _____

*Nr i telefonit _____

*** te domosdoshme per tu plotesuar!**

3. _____

4. _____

5. _____

6. _____

7. _____

Kryetar Seksioni

email _____

Sekretar Seksioni

email _____

Anëtar Kryesie Seksioni

Anëtar Kryesie Seksioni

Anëtar Kryesie Seksioni

Anëtar Kryesie Seksioni

Anëtar Kryesie Seksioni

Komisioni i Votimit

1. _____

2. _____

3. _____

Për Grupin e Punës

1. _____

2. _____

3. _____

Kryetari i Grupit të Punës

Emër Mbiemër

Firmë

SHTOJCA 2

Dega _____

Grupseksioni _____

_____, më / /2018

AKTI I ZGJEDHJEVE NË GRUPSEKSION

Mbështetur në Nenin 31 të PD, në mbledhjen zgjedhore të Grupseksionit _____ Dega _____, pas votimit u arritën rezultatet e mëposhtme:

Numri i seksioneve në këtë grupseksion në datën ____/____/ 2018 është _____.

Pjesemarres të pranishëm në mbledhje _____

Fletë votimi gjithsej _____

Fletë votimi të pavlefshme _____

Flete votimi të vlefshme _____

Shpërndarja e votave për secilin kandidat:

Emër	Atësi	Mbiemër	Vota	Emër	Atësi	Mbiemër	Vota
1.				4.			
2.				5.			
3.				6.			

Bazuar në rezultatet e mësipërme:

Kryetar/e i/e Grupseksionit shpallet z/znj. _____

*Nr i telefonit _____

*email _____

***te domosdoshme per tu plotesuar!**

Komisioni i Votimit

1. _____ 2. _____ 3. _____

Grupi i Punës

1. _____ 2. _____ 3. _____

Kryetari i Grupit të Punës për Qarkun

Emër Mbiemër

Firmë

Shtojca 3

Komisioni i Integritetit dhe Etikes

Formular Vetedeklarimi

Unë, _____,

lindur në _____, banues në _____,

me Numër Personal të letërnjoftimit _____;

Deklaroj me përgjegjësinë time se:

Plotësoj të gjitha kriteret e specifikuar në Urdhërin Nr..., dt.../.../..., për të garuar për funksionin e _____, Seksioni / Grupseksioni.

Unë,

Nuk kam qënë pjesë e Hetuesisë, Sigurimit të Shtetit dhe as bashkëpunëtor i tyre gjatë diktaturës komuniste.

Nuk jam dënuar asnjëherë penalisht për vepra të parashikuara në ligjin e dekriminalizimit dhe se ndaj meje nuk ka asnjë hetim për vepra të tilla në proces.

Emër Mbiemër

Firmë